



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 34  
Prishtinë, 10 mars 2009, ora 13: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.  
Munguan: Rita Hajzeraj dhe Slllobodan Petroviq

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati,

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri,

Nga KDI: Rrezarta Ahmeti

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

*Komisioni i zhvilloi punimet me këtë :*

**REND DITE**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës para miratimit në parim Nr. L-136;**
- 4. Përgatitje për takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me vërejtjet teknike të deputetes Gjylnaze Syla .*

## 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës para miratimit në parim

**Sadik Idriz** – Tha se edhe në mbledhjen e kaluar e kemi diskutuar këtë P/Ligj dhe tani do të jetë në shqyrtim edhe në seancën e radhës. Dilema nga mbledhja e kaluar ka qenë se a mund të shqyrtohet ku P/Ligj para miratimit të Ligjit për punën. Desha të sqaroj edhe çështjen e diskutuar në mbledhjen e kaluar lidhur me lejen e punës që i lëshon Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Kjo ministri bën vetëm regjistrimin e bizneseve por jo edhe lëshimin e lejeve të punës. Ka shumë njerëz që punojnë në Kosovë në profesione të ndryshme e që nuk janë të regjistruar askund dhe që nuk paguajnë tatime. Hap diskutimin.

**Mimoza Ahmetaj** - Tha se nga informatat që i kam marr nga Ministria e Tregtisë dhe nga Komunitat lidhur me bizneset e regjistruara në Kosovë , përveç mungesës së Ligjit të punës arsye e nevojës për këtë ligj është e pakontestueshme . Kemi shumë mjek që punojnë nga Maqedonia në Kosovë dhe që nuk janë të regjistruar askund dhe nuk paguajnë tatim. Pastaj ka edhe shumë profesor universiteti që punojnë në Kosovë dhe që nuk paguajnë tatim e mos të flasim për biznese tjera. E shoh të domosdoshme ta kemi këtë ligj.

**Gjylnaze Syla** - Tha se zyrtarët e ministrisë në mbledhjen e kaluar than se ligji ka të bëjë me dhënien e lejes ndërsa vet titulli i ligjit është për punësimin e të huajve, pra titulli i ligjit nuk përputhet me përmbajtjen e ligjit. Gjithashtu përfaqësuesit e ministrisë thanë që ky ligj nuk do të mund të zbatohet derisa të miratohet ligji i punës ose duhet të ketë disa dispozita kalimtare të cilat prapë do ta pamundësojnë zbatimin e plotë të ligjit. Pa ligjin bazë ky ligj nuk e arrin qëllimin e vet, prandaj ky ligj nuk duhet të jetë prioritet . Komisioni duhet të kërkoj nga ministria që ta sjell ligjin e punës e pastaj ta sjell këtë ligj.

**Teuta Hadri** - Tha se edhe pse mungon ligji i punës duhet të ekzistoj patjetër ky ligj sepse në Kosovë ka shumë punëtor si nga Kina , Afganistani dhe shtete të ndryshme të cilët pa asnjë kriter punojnë në Kosovë . Duhet sa më parë të miratohet ky ligj dhe të legalizohet puna e këtyre punëtorëve që punojnë në të zezë.

**Flora Brovina** - Tha se në procesverbal ka shumë çështje të thëna nga zyrtarët e ministrisë të cilët nuk e kanë arsyetuar mirë qëllimin që duhet ta arrijë ligji. Ka shumë qytetar që vijnë nga rajoni dhe të cilët nuk paguajnë tatim por ky ligj nuk i plotëson të gjitha qëllimet që ne presim dhe kemi dëshirë ti arrijmë me miratimin e këtij ligji. Ligji i punës është një ligj të cilit duhet dhënë prioritet e pastaj edhe këtij ligji.

**Mimoza Ahmetaj** - Tha se ekziston një marrëveshje në mes të MPMS dhe MPB që të gjithë qytetarët e huaj që kërkoj të kenë leje qëndrimi në Kosovë duhet të kenë patjetër leje të punës. Sa i përket numrit të bizneseve nga të dhënat që kam siguruar në komunën e Prishtinës janë të regjistruara rreth 250 deri në 300 biznese të huaja.

**Qamile Morina** - Tha se arsyetimi i përfaqësuesve të MPMS, për këtë ligj ishte se ka shumë punëtorë që po punojnë në të zezë në Kosovë dhe që qëllimi është të vihet një kontroll. Nga informatat që kam marr nga Administrata Tatimore e Kosovës , është që të huajt që punojnë në

Kosovë paguajnë tatim prandaj arsytimi i dhen nga përfaqësuesit e ministrisë në mbledhjen e kaluar nuk qëndron. Edhe në memorandumit shpjegues arsytimi i ligjit nuk është në pajtim me legjisllacionin e BE së.

Ky ligj nuk duhet të kaloj në Kuvend sepse ky ligj nuk parasheh kriteret e punësimit të të huajve prandaj do ti krijoj konkurrencë popullatës sonë të cilën e kemi të pa punë dhe nuk është në rregull. Kriteret e punësimit duhet të jen të qarta sepse shumë shtete e theksojnë që leje pune ju jepen vetëm kuadrove deficitare që ka nevojë shteti.

Gjithashtu sa i përket profesionistëve ceket në një nen në ligj se me marrëveshje dypalëshe, ekspertët nuk kanë nevojë për leje të punës, pra nuk është e qartë se çfarë punëtorësh do të punësohen me këtë ligj. Ky ligj nuk është i qartë dhe nuk është shumë urgjent.

**Gjylnaze Syla** - Tha se mungesa e politikës së mirëfilltë të punësimit nga ministria po sjell deri te hartimi i ligjeve anësore . Nuk mundet me qen prioritet ligji për punësimin e të huajve e nuk kemi ligj për punëtorët e Kosovës. Nuk mendoj që ky ligj duhet të kaloj në Kuvend.

**Bujar Bukoshi** - Tha se mungesa e ligjit bazë është evidente por nuk mendoj që ka ndonjë pengesë që ligji duhet të kaloj. Kosova duhet të jep sinjale se ka filluar ndërtimin e një rregulli edhe në këtë lami.

**Nurishahe Hulaj** - Tha që a duhet të kaloj ligji apo jo duhet të vendos Kuvendi , ne të mos bëjmë asnjë propozim.

**Sadik Idriz** - Tha se ligji do të jetë në lexim të par në seancën e radhës dhe ne i kemi dilemat që i kemi për këtë ligj. Përfaqësuesit e ministrisë nuk mundën të japin arsyet dhe argumentet rreth dilemës që kemi , prandaj të shohim se si do të vendos Kuvendi . Do ti marrim edhe propozimet që do të dalin nga leximi i par në Kuvend pastaj ne si komision funksional do të procedojmë me P/Ligjin.

**Flora Brovina** - Tha se sipas rregullores për punën , UNMIK- u ka bërë diskriminim të punëtorëve të Trepçës ku janë diskriminuar shumica shqiptare dhe janë favorizuar minoritetet. Nuk dëshiroj të bëjmë ligje ku do të jen të diskriminuar shumica. Mandej ne mund të miratojmë ligje por sa po mund ti zbatojmë ato.

**Gjylnaze Syla** - Tha se jam e mendimit që ligjin duhet të ja kthejmë ministrisë dhe ti rekomandojmë që sa më par të sjell ligjin e punës e pastaj këtë ligj.

**Nurishahe Hulaj** - Tha se si komision funksional nëse i themi në seancë këto që po themi këtu atëherë ligji do të kthehet, por mendoj se ne do të marrim qëndrimin e Kuvendit e pastaj të procedoj me këtë ligj.

**Qamile Morina** - Tha se qëllimi i ligjit është i qartë sepse titulli i ligjit është „ Ligji për punësimin e të huajve “ e jo për lejen e punës së të huajve.

**Teuta Hadri** - Tha se ata punëtor janë duke punuar por qëllimi është që ata të regjistrohen dhe të mos punojnë në të zezë.

**Sadik Idriz** - Tha se pas diskutimeve ne mund të konkludojmë se Komisioni ka mjaft dilema lidhur me këtë ligj , megjithatë Kuvendi do ta jep vendimin e vet për këtë ligj dhe Komisioni pastaj do ta bëj punën e vet. Ky do të jetë edhe një rast i mirë për ti bërë presion Ministrin që sa më parë ta sjell ligjin e punës.

#### **4. Përgatitje për takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;**

**Sadik Idriz** - Tha se për javën e ardhshme sipas planit të punës së Komisionit do të ftojme në takim së pari ministrin e punës dhe mirëqenies sociale . Sipas planit ministri raporton në Komision për ligjet , aktet nënligjore , programet , realizimin e projekteve kapitale dhe sfidat e kësaj ministrie. Ne ftesës për pjesëmarrje në mbledhje të Komisionit mund ti shtojmë edhe tema të tjera por mund të shtrojmë edhe pyetje shtesë që na interesojnë gjatë mbledhjes.

**Flora Brovina**- Propozoj që nga ministri që të informohemi për statistikave sepse përmes statistikave ne mund ti përcjellim edhe politikat e kësaj ministrie. Gjithashtu na intereson se çka ka bërë kjo ministri në realizimin e planit të mijëvjeçarit i cili është aprovuar për luftimin e varfërisë.

**Gjynaze Syla** - Tha se më intereson se cilat janë politikat e ministrisë për punësimin, çka është bërë në vitin 2008 dhe çfarë planifikohet për vitin 2009. Çfarë është bërë në luftimin e varfërisë gjatë vitit 2008 dhe çfarë planifikohet për 2009. Sa po zbatohet skema sociale, a është rritur apo është zvogëluar numri i atyre që janë të përfshirë në skemën sociale.

Ku janë në procedurë ligji për pensionet, Ligji për punën dhe shumë ligje tjera. Çka ka zbatuar nga prioritete e ministrisë gjatë vitit 2008 dhe çka ka planifikuar si prioritet për vitin 2009.

**Sadik Idriz** - Tha se ne do ti bëjmë një ftes ministrit për pjesëmarrje në mbledhjen e radhës dhe do të diskutojmë temat që u ceken këtu , por mund të shtrohen edhe pyetje tjera që na interesojnë.

**Mimoza Ahmetaj**- Propozoj që në ftes të ceket që ministri mund të na sjell edhe materialet me shkrim lidhur me temat që do të diskutohen.

#### **5. Të ndryshme.**

**Gjynaze Syla** - Njoftoj anëtarët e Komisionit se përfaqësuesja e FES- it është e interesuar për ta mbështetur punën e Komisionit lidhur me ligjin për sigurime shëndetësore.

*Mbledhja përfundoi në orën 12: 20.*

*E përgatiti:*

*Njësia për Mbështetjen e Komisionit.*

Kryetar i Komisionit

Sadik Idriz